34.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për menjanimin e defekteve, ose dëmeve, në ndonjë pjesë të punëve të cilat mund të shfaqen apo shfaqen gjatë periudhës së defekteve dhe të cilat lindin nga ose:

- a) përdorimin i impiantit ose materialeve të dëmtuara ose mjeshtëria ose dizajni i gabueshme i Kontraktuesit; dhe / ose
- b) çdo veprim apo mosveprim i Kontraktuesit gjatë periudhës së defekteve.

34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rinovimet do të fillojë nga data kur zëvendësimi ose rinovimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranim të pjesshëm, periudha e defekteve do të vazhdohet vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërrimi apo rinovim.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së përmendur, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigjojë një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të kryejë vetë punë, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto të Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
- b) të ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejnë punën në kurriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë së defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë së defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë së defekteve do të fillojë në datën e pranimit të përkohshëm.

Neni 35 Pranimi përfundimtar

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një **certifikatë të pranimit përfundimtar**, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimit do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimit nga Menaxheri i Projektet dhe të jete dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit dhe të cilat kanë mbetur të përcaktuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimit. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

Shkelja e kontratës dhe shkelputja

Neni 36 Shkelja e kontratës

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet: dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme: ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhet Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

Neni 37 Shkëputja e kontratës

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërpre punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonës;
- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundojë vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më parë që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të sigurojë vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

Neni 38 Forca madhore

38.1 "Force Madhore" siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplozimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësitë të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

Neni 39 Pagesa pas shkëputjes së kontratës

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshojë një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

Neni 40 Prona

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41 Lirimi nga Ekzekutimi

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetojë këtë. Kontraktuesi do të sigurojë vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundur. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja

për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo qe palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

PJESA III E KONTRATES KUSHTET E VECANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha Shqipe .
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shuma e sigurisë së ekzekutimit është 10% i vlerës së kontratës me vlefshmëri prej 120 DITESH
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë të tyre, materialet apo impiantin gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsye, përpos rreziqeve të definuara sipas nenit 38 të KPK, kontraktuesi korrigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkesave të menaxherit të kontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe impiantin gjer në koston e zëvendësimit të plotë; (b) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre; (c) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar. (d) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje: (i) e punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar (ii) e personave të tjerë: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzojë për aprovim Programin për Punët brenda 15 ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.

	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është 15 ditë nga data e pranimit të kërkesës së Menaxherit të projektit.
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë 10 dite pas nënshkrimit të kontratës.
	17.2	Data e përfundimit të të gjitha Punëve do të jetë 90 ditë.
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.25% e Çmimit përfundimtar të Kontratës për ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10% e Çmimit final të Kontratës.
Regjistri i punës	20.1	Një regjistër i punës do të mbahen në vend-punishite nga ana e Kontraktuesit,
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit caktohet me vendim nga ZKA
Pagesat	24.2	Pagesat do të behen ne situacione ne baze te raporteve te menagjerit te projektit per vlerat e ralizimit 50000,00€ apo me shume
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: nuk ka pagese paraprake
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: 10% i vlerës së kontratës. Mbajtja e parasë mund të zëvendësohet me një sigurim nga banka apo kompania e sigurimeve prej 10% nga çmimi i kontratës per periudhën garantuese te parapare ne piken 34.5.
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë sipas planit të menaxhimit të kontratës.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periudha garantuese e defekteve është 5 vite nga dita e pranimit të punimeve.
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve të likuiduara.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Komisioni për Ndërmjetësim në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve	43.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të

<p>me procedurë gjyqësore</p>		<p>zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën Themelore-Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë.</p> <p>ose</p> <p>b) kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë.</p> <p>Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.</p>
-------------------------------	--	---

PJESA C: FORMULAR PËR DORËZIMIN E TENDERIT

Pjesa I. Formulari i Tenderit

Për: KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES

(në vazhdim të tekstit "Autoriteti Kontraktues")

Titulli i kontratës: Rrethrrrotullimi Lakrishtë-Rrethrrrotullimi Arbëri

Si përgjigje ndaj letrës suaj të ftesës për të tenderuar për kontratën e mësipërme, ne, të poshtë nënshkruarit, deklarojmë që:

1. I kemi kontrolluar dhe pranuar plotësisht përmbajtjet e dosjes së tenderit me Numër të Prokurimit: 616-18-3326-5-1-2. Ne pranojmë dispozitat e saj në tërësi, pa rezervim ose kufizim.

2. Ne ofrojmë të dorëzojmë, në pajtim me kushtet e dosjes së tenderit dhe afatet kohore të paraqitura, pa rezervë apo kufizim:

3. Çmimi total i tenderit është:

[Nëse objekti i kontratës nuk është i ndarë në pjesë]

Çmimi i tenderit në shifra: [shëno çmimin e tenderit në shifra €]

1,149,998⁸⁷ €

Dhe në fjalë [shëno çmimin e tenderit në fjalë Euro]

NJË MILION ENJËQIND E DNYZETË E DËNTË HUNDË
E TËTËDHAJËTË E SHATËTË CENT.

4. Ky tender është valid për një periudhë prej **90 dite** nga data finale për dorëzim të tenderëve.

5. [Nëse tenderi jonë pranohet, ne marrim përsipër të sigurojmë një siguri të ekzekutimit para nënshkrimit të kontratës **[10% E VLERES SE KONTRATES NE AFAT PREJ 120 DITESH]**].

6. Operatori Ekonomik [dhe nënkontraktuesit tonë] kanë këtë nacionalitet: **KOSOVE**

7. Ne e bëjmë këtë kërkesë, për këtë tender [shëno numrin e Pjesës, nëse aplikohet], me të drejtën tonë të udhëhequr nga ne. Ne konfirmojmë që nuk jemi duke tenderuar për të njëjtën kontratë me ndonjë formular tjetër.

[Në rast të konsorciumit]

[Ne e bëjmë këtë kërkesë, për këtë tender [shëno numrin e Pjesës, nëse aplikohet] si partner në konsorcium të udhëhequr nga [shëno emrin e udhëheqësit]. Ne konfirmojmë që nuk jemi duke tenderuar për të njëjtën kontratë me ndonjë formular tjetër. Konfirmojmë, si partner në konsorcium, se të gjithë partnerët, bashkërisht dhe veç e veç, janë të detyruar me ligj për realizim të kontratës; se partneri kryesor është i autorizuar të obligojë dhe të marrë udhëzime për secilin anëtar dhe në emër të secilit anëtar që realizimi i kontratës, duke përfshirë edhe pagesat, është përgjegjësia e partnerit kryesor, dhe se të gjithë partnerët në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium janë të obliguar të mbeten në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium gjatë tërë periudhës së realizimit të kontratës].

8. Ne do ta informojmë Autoritetin kontraktues menjëherë nëse ka ndonjë ndryshim në rrethanat e mësipërme në cilëndo fazë gjatë implementimit të kontratës. Gjithashtu ne e dimë dhe pranojmë që të gjitha informatat e pasakta ose jo të plota të cilat jepen me qëllim në këtë konkurrim, mund të kenë si rezultat përjashtimin tonë nga kjo dhe nga kontratat tjera të financuara nga BKK.

9. Theksojmë që Autoriteti kontraktues nuk është i obliguar të vazhdojë me këtë ftesë dhe që e rezervon të drejtën për të dhënë vetëm një pjesë të kontratës. Ai nuk do të shkaktojë detyrime ndaj nesh nëse e bën këtë.

E DORËZUAR NGA

IDENTIFIKIM I OPERATORIT EKONOMIK	
EMRI I KOMPANISË	RSM COMPANY SHPK
ADRESA E PLOTE	CAGLLAVICE, P.N. PRISHTINE
PËRFAQËSUAR NGA:	
EMRI	AGIM KOLA
POZITA	DREJTOR
NËNSHKRIMI	
DATA	27.08.2018
VULA	

[Në rast Grupi Operatorësh ekonomik:]

	Emri (emrat)	Vend-selia
Partneri 1*	////////////////////////////////////	////////////////////////////////////
Etj ... *	////////////////////////////////////	////////////////////////////////////

* shtoni/fshini rreshta plotësues për partnerët sipas nevojës. Vini re që nënkontraktuesi nuk konsiderohet si partner për qëllime të kësaj procedure të tenderit.

Emri dhe mbiemri i personit të autorizuar për të nënshkruar këtë tender në emër të Konsorciumit: [shëno emrin dhe mbiemrin]

Nënshkrimi: [nënshkrimi i personit të autorizuar]

Vendi dhe data: [shëno vendin dhe datën]

Vula e Udhëheqësit: _____

Pjesa II. PARAMASA DHE PARALLOGARIA

Te bashkangjitur ne platforme

IDENTIFIKIM I OPERATORIT EKONOMIK (OE)	
EMRI I OE:	RSM COMPANY SHPK
EMRI DHE MBIEMRI I PËRFAQËSUESIT TE OE:	AGIM KOLA
NËNSHKRIMI:	
DATA:	27.08.2018
VULA:	



PARAMASA DHE PARALLOGARIA
PROJEKTI KRYESOR I RRUGËS:
Rrethrotullimi Lakrishte-Rrethrotullimi Arbëri
(Krahu Majtas), Km:0+337-1+100, L=763.0, **nr.prokurimit**
616 16 012 221, dhe nr. I projektit 06/16/3D

Aksi Kryesorë L=763, Akset sekondare:49.5+60.0+51.32+55.18=216.0m

Nr. rendor	Lloji i punës	Njësia	Sasia	Çmimi njësi (Euro)	Çmimi total (Euro)
1	PUNËT PARAPRAKE				
1.1	Shenimi i trasesë para fillimit të punimeve dhe gjatë ekzekutimit (Sipas Projektit).	m'	979.00	1.00	979.00
1.2	Hartimi I projektit të ekzekutuar pas perfundimit të punimeve, (aty ku projekti ka pësuar ndryshime).	m'	979.00	1.00	979.00
1.3	Demolimi I murit mbrojtës nga beton armeja nga km:1+60-1+100 në anen e djathtë të rruges si dhe largimi deri në deponi.	m ³	132.00	5.00	660.00
1.4	Demolimi I murit mbrojtës nga beton armeja në dy anet e nyjes në km:0+440 si dhe largimi deri në deponi.	m ³	105.60	5.00	528.00
1.5	Demolime I materialeve të ngurta si beton, asfalt dhe materiale tjera duke përfshir edhe transportin deri në deponi.	m ³	4.50	5.00	22.50
1.6	Demolime I shtresave të asfaltit edhe transportin deri në deponi.	m ²	1,487.00	1.00	1,487.00
1.7	Demolime I gurëve skajor duke përfshir edhe transportin deri në deponi.	m'	315.00	2.00	630.00
1.8	Demontimi i rrethojave të ndryshme nga shufrat prej çeliku dhe kthimi I tyre në gjendjen e mëparshme pas perfundimit të projektit.	m'	15.00	20.00	300.00
PUNËT PARAPRAKE				Gjithsej:	5,585.50



PUNIMET E DHEUT					
2.1	Gërmimi i dheut i kategorisë së III-të, IV-të dhe me ngarkim dhe bartje deri në deponi në largësi 15km.	m ³	24,210.00	0.80	19,368.00
2.2	Grryerja, planifikimi, rrafshimi i nënbazës dhe ngjeshje deri në modulën e ngjeshmerisë 20N/mm ²	m ²	17,820.00	0.20	3,564.00
2.3	Furnizimi, transporti dhe shtrirja e gjeotekstitit 400gr/m ²	m ²	17,890.00	0.80	14,312.00
2.4	Furnizimi, transporti, punimi i materialit mbushës guror jokoherent me CBR>20% , shtrirje dhe ngjeshja në shtresa jo më të mëdha se 30cm deri në modulën e ngjeshmerisë 60MN/m ²	m ³	20,735.00	3.40	70,499.00
2.5	Furnizimi, transporti dhe punimi i bankinës prej materialit guror me fraksion 0/32mm.	m ³	285.00	7.00	1,995.00
2.6	Humusim duke përfshirë: Furnizimi, transporti , planifikimi dhe gjelbrimi I krahve të rruges.	m ²	350.00	2.00	700.00
PUNIMET E DHEUT					110,438.00



3		MBISTRUKTURA RRUGA KRYESORE			
3.1	Furnizimi, transporti , planifikimi dhe ngjeshja e tamponit (Msh=100MN/m ²) prej gurit të thyer gëlqeror 0-60mm me trashësi t=40cm.	m ³	4,509.75	6.00	27,058.50
3.2	Furnizimi, transporti , planifikimi dhe ngjeshja e tamponit (Msh=120MN/m ²) prej gurit të thyer gëlqeror 0-32mm me trashësi t=15cm.	m ³	1,976.10	6.80	13,437.48
3.3	Furnizimi, bartja, shtrirja dhe ngjeshja e rëres së imt si shtres rrafshuese nën kubëza betoni me t=5cm.	m ³	129.20	10.00	1,292.00
3.4	Furnizimi dhe punimi i shtresës së bitoagregatit: BA 32-BIT 50/70, me trashësi t=10cm duke përfshir spërkatjen me emulsion 0.5/kg/m ² .	m ²	7,401.10	9.00	66,609.90
3.5	Furnizimi dhe punimi i asfaltit binder BA22 - BIT 50/70 me trashësi t=7cm, me spërkatjen me emulsion 0.5/kg/m ² të sipërfaqes së bito agregatit.	m ²	7,401.10	7.20	53,287.92
3.6	Furnizimi dhe punimi i asfaltbetonit SMA 11 (stone mastic asphalt - agregati eruptiv) PmB 50/70-65) me trashësi t=4cm, me spërkatjen me emulsion 0.5/kg/m ² të sipërfaqes së binderit.	m ²	7,401.10	6.30	46,626.93
3.7	Furnizimi dhe punimi i shtresës së bituzhavorit në hapsirat e shiritit të biqiklistave BZH22, me trashësi t=7cm duke përfshir spërkatjen me emulsion 0.5/kg/m ²	m ²	1,522.00	7.20	10,958.40
3.8	Furnizimi dhe punimi i asfaltit betonit në hapsirat e shiritit të biqiklistave AB11 me trashësi t=4cm, duke përfshirë spërkatjen me emulsion 0.5/kg/m ² të sipërfaqes së bito zhavorit.	m ²	1,522.00	5.50	8,371.00
3.9	Furnizimi, bartja dhe vendosja e skajorëve 18/24 C40/50, M100 në shtresë betoni MB20	m'	1,485.00	8.00	11,880.00
3.10	Furnizimi, bartja dhe vendosja e skajorëve 8/20 C40/50, M100 në shtresë betoni MB20	m'	2,295.00	6.00	13,770.00
3.10	Furnizimi, transporti dhe punimi i kubzave nga betoni me t=8cm, me C40/50 , M100 per truare sipas projektit .	m ²	2,294.00	8.50	19,499.00
3.11	Furnizimi, transporti mbushja me dhe humosor, planifikimi dhe mbjellja e barit në hapsirat e gjelberta.	m ²	456.00	3.00	1,368.00
GJITHËSEJ PUNËT E MBISTRUKTURES					274,159.13



4	MBISTRUKTURA RRUGËT LIDHËSE				
4.1	Furnizimi, transporti , planifikimi dhe ngjeshja e tamponit (Msh=100MN/m ²) prej gurit të thyer gëlqeror 0-60mm me trashësi t=40cm.	m ³	955.00	6.50	6,207.50
4.2	Furnizimi, transporti , planifikimi dhe ngjeshja e tamponit (Msh=120MN/m ²) prej gurit të thyer gëlqeror 0-32mm me trashësi t=15cm.	m ³	375.00	7.00	2,625.00
4.3	Furnizimi, bartja, shtrirja dhe ngjeshja e rëres së imt si shtres rrafshuese nën kubëza betoni me t=5cm.	m ³	65.00	12.00	780.00
4.4	Furnizimi dhe punimi i shtresës së bitoagregatit: BA 32-BIT 50/70, me trashësi t=10cm duke përfshir spërkatjen me emulsion 0.5/kg/m ² .	m ²	1,215.00	10.00	12,150.00
4.5	Furnizimi dhe punimi i asfaltit binder BA22 - BIT 50/70 me trashësi t=7cm, me spërkatjen me emulsion 0.5/kg/m ² të sipërfaqes së bito agregatit.	m ²	1,215.00	7.50	9,112.50
4.6	Furnizimi dhe punimi i asfaltbetonit SMA 11 (stone mastic asphalt - agregati eruptiv) PmB 50/70-65) me trashësi t=4cm, me spërkatjen me emulsion 0.5/kg/m ² të sipërfaqes së binderit.	m ²	1,215.00	6.50	7,897.50
4.7	Furnizimi, bartja dhe vendosja e skajorëve 18/24 C40/50, M100 në shtresë betoni MB20	m ¹	393.00	8.00	3,144.00
4.8	Furnizimi, bartja dhe vendosja e skajorëve 8/20 C40/50, M100 në shtresë betoni MB20	m ¹	345.00	6.00	2,070.00
4.9	Furnizimi, transporti dhe punimi i kubzave nga betoni me t=8cm, me C40/50 , M100 per troruare sipas projektit .	m ²	1,003.00	9.00	9,027.00
4.9	Furnizimi, transporti mbushja me dhe humusor, planifikimi, mbjellja e barit , gjelbrimit të ulët dhe luleve në hapsirat e parapara per gjelbrim.	m ²	568.00	3.00	1,704.00
4.10	Furnizimi, transporti dhe mbjellja e dryjve dekorative (Katallpa ose të ngjashëm në kordinim me mbikqyrësin) me lartësi h=300cm dhe diameter të trungut D=80mm (në kosto të përfshihet mirmbajtja dhe zëvendësimi i atyre që nuk nxëjn në periudh një vjeqare)	copë	76.00	30.00	2,280.00
GJITHËSEJ PUNËT E MBISTRUKTURES					56,997.50



5	TË NDRYSHME				
5.1	Furnizimi, transporti dhe montimi i gypave te perforuar-kuagurua (drenazhit) Φ 250mm duke perfshir edhe bazen nga betoni i thjesht me formë si në vizatime.	m'	580.0	7.00	4,060.00
5.2	Furnizimi, transporti dhe montimi i gypave te kuaguruar Φ 200mm për shkarkimin e ujit të drenazhimit të rrugës dhe mureve mbrojtëse në pusetat e kanalizimit atmosferik.	m'	95.0	5.00	475.00
5.3	Furnizimi, transporti dhe montimi gjeotekstilit filtrues 350gr/m2 per mbylljen e drenazhit me formë si në vizatime.	m ²	2135.0	1.00	2,135.00
5.4	Furnizimi, transporti dhe montimi zhavorit të lumit me fraksion 30-60mm për drenazh me formë si në vizatime.	m ³	285.0	10.00	2,850.00
5.5	Furnizimi dhe montimi i parrmakëve për këmbësor me konstruksion prej profileve të zinktuara të çelikut të vendosur përgjatë mureve mbrojtëse me Lartësi 80cm , mbajtës vertikal Φ 75mm , mbajtesit kryesor horizontal Φ 75mm si dhe me mbushje vertikale Φ 20mm, me formë si në vizatime (të llogaritet dy shtresa bazë dhe dy shtresa neivrrë).	m'	764.0	45.00	34,380.00
5.6	Furnizimi dhe montimi i parrmakëve për këmbësor me konstruksion prej profileve të zinktuara të çelikut të vendosur përgjatë mureve mbrojtëse me Lartësi 70cm ,mbajtës vertikal Φ 75mm , mbajtesit kryesor horizontal Φ 75mm si dhe me mbushje vertikale, me formë si në vizatime (të llogaritet dy shtresa bazë dhe dy shtresa neivrrë).	m'	123.0	40.00	4,920.00
5.7	Furnizimi Transporti dhe vendosja në veper e pahive elastike standarte tip B e njëfisht	m'	763.0	22.00	16,786.00
GJITHSEJ PUNËT E NDRYSHME					65,606.00




6 SINJALIZIMI VERTIKAL					
6.1	Furnizimi dhe vendosja (përfshirë të gjitha operacionet dhe pajisjet mbajtëse) e shenjave të trafikut në formë trekëndëshe me gjatësi të brinjës së trekëndëshit barabrinjës prej 900 mm., sipas detalit në specifikime.	copë	2.00	50.00	100.00
6.2	Furnizimi dhe vendosja (përfshirë të gjitha operacionet dhe pajisjet mbajtëse) e shenjave të trafikut në formë rrethore përfshirë dhe shenjen STOP me diametër 600 mm, sipas detalit në specifikime.	copë	9.00	50.00	450.00
6.3	Furnizimi dhe vendosja (përfshirë të gjitha operacionet dhe pajisjet mbajtëse) e tabelave drejtkëndore të informimit me dimensione 600x600mm, sipas detalit në specifikime.	copë	6.00	50.00	300.00
6.4	Verejtje: Foliet e sipërfaqeve retroreflektuese të shenjave të trafikut duhet të punohen së paku të shkallës së dytë retro-reflektuese të tipit Diamong Grade - DG.				
SINJALIZIMI VERTIKAL				Gjithsej:	850.00

7 SINJALIZIMI HORIZONTAL					
7.1	Furnizimi dhe punimi në rrugë i vijave të bardha të plota (gjerësia 150 mm)	m'	320.00	1.50	480.00
7.2	Furnizimi dhe punimi në rrugë me vija të bardha të nderprera (3+3 m, me gjerësi 150 mm)	m'	810.00	1.50	1,215.00
7.3	Furnizimi dhe punimi në rrugë me vija të bardha të nderprera (1+1 m, me gjerësi 150 mm)	m'	100.00	1.50	150.00
7.4	Furnizimi dhe punimi në rrugë me vija të bardha të nderprera (0.5+0.5 m, me gjerësi 500 mm)	m'	96.00	1.50	144.00
7.5	Furnizimi dhe punimi në rrugë me vija të verdha të nderprera (1+1 m, me gjerësi 100 mm)	m'	810.00	1.50	1,215.00
7.6	Furnizimi dhe punimi në rrugë me vija të bardha tërthore të nderprera (0.5+0.5m, me gjerësi 500 mm)	m'	15.00	1.50	22.50
7.7	Furnizimi dhe punimi në rrugë i vijave të bardha për shenimin e vendeve të parkimit paralel me aksin e rrugës (gjerësia 150 mm)	m'	630.00	1.50	945.00
7.8	Furnizimi dhe punimi në rrugë me shigjeta për lëvizje majtas, djathtas, majtas dhe djathtas (me gjatësi 5 m)	copë	20.00	20.00	400.00
7.9	Furnizimi dhe punimi në rrugë për shenimin e vendkalimit të kembësoreve	m ²	130.00	15.00	1,950.00
7.10	Simboli i biçikletave në rrugë	copë	18.00	25.00	450.00
7.11	Verejtje: Shenjat horizontale duhet të punohen nga masat e perziera plastike dy komponentëshe me perberje të grimcave fluroscente				

7.0 SINJALIZIMI HORIZONTAL

Gjithsej:

6,971.50

A handwritten signature in black ink, located in the bottom right corner of the page. The signature is stylized and appears to be a personal name.

PARAMASA DHE PARALLOGARIA
PROJEKTI KRYESOR I RRUGËS:
Rrethrrrotullimi Lakrishte-Rrethrrrotullimi Arbëri
(Krahu Majtas), Km:0+337-1+100, L=763.0,
nr.prokurimit 616 16 012 221, dhe nr. I projektit 06/16/3D

1	PUNËT PARAPRAKE	5,585.50
2	PUNIMET E DHEUT	110,438.00
3	MBISTRUKTURA RRUGA KRYESORE	274,159.13
4	MBISTRUKTURA NË RRUGËT LIDHËSE	56,997.50
5	TË NDRYSHME	65,606.00
6	SINJALIZIMI VERTIKAL	850.00
7	SINJALIZIMI HORIZONTAL	6,971.50
	TOTALI ME (TVSH)	520,607.63



PARAMASA DHE PARALLOGARIA E PUNËVE PËR KANALIZIMIN FEKAL
Rrethrotullimi Lakrishte-Rrethrotullimi Arbëri

Nr. rendor	Pozicioni (sipas kushteve teknike)	Lloji i Punës	Njësia	Sasia	Çmimi njësi	Çmimi total EURO
1.0 PUNËT E DHEUT						
1.0		Trasimi dhe inçizimi me shenjat gjeodezike	m'	720	1.00	720.00
1.1		Gërmimi me dorë dhe me makina si dhe Deportimi i dheut të tepërt, me ngarkim dhe shkarkim në vendin ku e cakton organi mbikqyrës, dheu është i kateg. së III-të dhe IV-të në proporcion 90% dhe 10%. Tehet e kanaleve duhet të gërmohën në formë të rregullt dhe të përpunohet fundi i kanalit. Dheu i mihur duhet të menjahohet larg kanalit në largësi min. 1,00 m'. -Gërmimi me makina në thellësinë mesatare të kanalit deri në 2.0 m' (duke llogarit edhe shtresat e konstruksionit të rrugës), kurse gjërësia varet nga profili (Ø) i gypit, në çmim duhet llogaritur edhe mbrojtja e kanalit nga shembja				
1.2		gërmimi me makinë 90%	m ³	1180	1.00	1,180.00
1.3		gërmimi me dorë 10%	m ³	130	1.00	130.00
1.4		Zgjerimi dhe thellimi në vendet e pusetave. Zgjerimi bëhet për nga 50 cm dhe thellimi për 40 cm, në dy metër gjatësi kol. 18 puseta	m ³	8	10.00	80.00
1.5		Planifikimi i fundit të kanalit pas përfundimit të gërmimit duke dhënë ramjen e saktë sipas projektit. Llogaritja bëhet për 1 m2 të sipërfaqes reale të planifikuar.	m2	650	2.00	1,300.00
1.6		Furnizimi, shtrierja dhe mbulimi i gypave me shtresë rëre dhe zhavori d=0-4mm, sipas detajit ne projekt.	m ³	300	10.00	3,000.00
1.7		Furnizimi, transporti dhe vendosja e shiritit sinjalizues mbi shtresen e zhavorit standart per rrjeta te kanalizimit fekal.	m'	720	1.00	720.00
1.8		Mbushja dhe mbulimi i kanalit me zhavor 0-60mm duke e ngjeshur në shtresa 20-30 cm. Shtresa e parë mbi dhe rreth gypave është 5 cm. rërë.	m ³	850	7.00	5,950.00
TOTAL PUNËT E DHEUT :						13,080.00

Nr. rendor	Pozicioni (sipas kushteve teknike)	Lloji i Punës	Njësia	Sasia	Çmimi njësi	Çmimi total EURO
		2,0 PUNËT E BETON. DHE BET.ARME				
	2.0	Përpunimi i fundit të pusëtës kontrolluese me MB-20 (për kryerjen e kinetave). Trashësia (lartësia) mesatare e fundit është 30 cm. Këto funde shërbejnë si bazë për vendosjen e unazave të gatshme montuese nga betoni Ø1000 mm, kurse diamaterin e kanë 1.300 mm.	m ³	7.2	10.00	72.00
	2.1	Furnizimi dhe ndërtimi i unazave montuese të betonit me shpuarjen e shprastirave për vendosjen e gypave të kanalizimit, lidhja e gypave me llaq çimentoje. Për secilën pusetë është e nevojshme të furnizohen unazat e prerjes konstante Ø1000mm dhe nga një unazë në formë të konit (Ø1000mm në Ø700mm) në pjesën e ngushtë të të cilit montohet korniza me kapakun e rëndë, shkurtohet sipas nevojës në varshmëri të ndryshimit të lartësisë së pusëtës. Është e nevojshme të furnizohen unaza në formë të konit dhe me formë konstante:				
	2.2	a) unaza në formë të konit	copë	18	50.00	900.00
	2.3	b) me profil konstant	m'	36	50.00	1,800.00
					TOTALI	2,772.00
		3,0 PUNËT METAL PUNUESE				
	3.0	Furnizimi transporti montimi dhe betonimi i kapakëve prej gize për peshë të rënda D400, T=40t, DN-600. Në çmim të llogaritet edhe betonimi i kurorës prej betonarmesë C-25/30.	copë	18	120.00	2,160.00
3	3.1	Furnizimi, transporti dhe vendosja e betonimit për kineta më përpunim sipas detalit.	m ³	3.6	60.00	216.00
	3.2	Shkallët në puseta Furnizimi, transporti dhe ndërtim montimi i shkallëve të hekurta Ø 20 mm në murin e pusëtës. Shkallat të vendndërtohen në çdo 30 cm me ngjyrosje kundër korozionit. Logaritja me copë.	copë	150	3.00	450.00
					TOTALI	2,826.00
		4,0 PUNËT E MONTUESE				
4	4.0	Furnizimi, transporti dhe montimi i tubave të brinjëzuar PE SN8 për kolektorë Pagesa bëhet për 1 m' të gypit të montuar komplet.				
	4.1	për kolektorë Ø- 200 mm	m'	70	6.00	420.00
	4.2	për kolektorë Ø- 250 mm	m'	200	8.00	1,600.00
	4.3	për kolektorë Ø- 315 mm	m'	490	15.00	7,350.00
					TOTALI	9,370.00

5	5,0 TESTIMI DHE SHQYRTIMI I RRJETIT					
	5.0	Testimi dhe shqyrtimi i rrjetit te kanalizimit fekal sipas normave teknike.				
	5.1	pagesa bëhet me m' te gypit te montuar.	m'	720	1.50	1,080.00
					TOTALI	1,080.00

Rrethrotullimi Lakrishte-Rrethrotullimi Arbëri		
1.0	PUNËT E DHEUT	13,080.00
2.0	PUNËT E BETONIT DHE BETON-ARME	2,772.00
3.0	PUNËT METAL-PUNUESE	2,826.00
4.0	PUNËT MONTUESE	9,370.00
5.0	TESTIMI I RRJETIT	1,080.00
Totali:		29,128.00



PARAMASA DHE PARALLOGARIA E PUNËVE PËR KANALIZIMIN ATMOSFERIK
Rrethrotullimi Lakrishte-Rrethrotullimi Arbëri

Nr. rendor	Pozicioni (sipas k. tek)	Lloji i Punës	Njësia	Sasia	Çmimi njësi	Çmimi total EURO
		1.0 PUNËT E DHEUT				
	1.0	Trasimi dhe inçizimi me shenjat gjeodezike	m'	720	1.00	720.00
	1.1	Gërmimi me dorë dhe me makina, si dhe Deportimi i dheut të tepërt, me ngarkim dhe shkarkim në vendin ku e cakton organi mbikqyrës, dheu është i kateg. së III-të dhe IV-të në proporcion 90% dhe 10%. Tehet e kanaleve duhet të gërmohën në formë të rregullt dhe të përpunohet fundi i kanalit. Dheu i mihur duhet të menjahet larg kanalit në largësi min. 1,00 m'. - Gërmimi me makina në thellësinë mesatare të kanalit deri në 1.8 m' (duke llogaritur edhe shtresat e konstruksionit të rrugës), kurse gjërësia varet nga profili (Ø) i gypit, në çmim duhet llogaritur edhe mbrojtja e kanalit nga shembja				
	1.2	gërmimi me makinë 90%	m ³	1000	1.00	1,000.00
	1.3	gërmimi me dorë 10%	m ³	110	1.00	110.00
1	1.4	Zgjerimi dhe thellimi në vendet e pusetave. Zgjerimi bëhet për nga 50 cm dhe thellimi për 40 cm, në dy metër gjatësi kol. 18 puseta	m ³	8	10.00	80.00
	1.5	Planifikimi i fundit të kanalit pas përfundimit të gërmimit duke dhënë ramjen e saktë sipas projektit. Llogaritja bëhet për 1 m2 të sipërfaqes reale të planifikuar.	m ³	650	1.00	650.00
	1.6	Furnizimi, shtrierja dhe mbulimi i gypave me shtresë rëre dhe zhavori d=0-4mm, sipas detajit ne projekt.	m ³	300	10.00	3,000.00
	1.7	Furnizimi, transporti dhe vendosja e shiritit sinjalizues mbi shtresen e zhavorit standart per rrjeta te kanalizimit atmosferik.	m'	720	1.00	720.00
	1.8	Mbushja dhe mbulimi i kanalit me zhavor 0-60mm duke e ngjeshur në shtresa 20-30 cm. Shtresa e parë mbi dhe rreth gypave është 5 cm. rëre.	m ³	720	7.00	5,040.00
TOTAL PUNËT E DHEUT :						11,320.00

Nr. rendor	Pozicioni (sipas k. tek)	Lloji i Punës	Njësia	Sasia	Çmimi njësi	Çmimi total EURO
		2,0 PUNËT E BETON. DHE BET.ARME				
	2.0	Perpunimi i fundit të pusetes kontrolluese me MB-20 (për punimin e kinetave) . Trashësia (lartësia) mesatare e fundit është 30cm. Këto funde shërbejnë si bazë për vendosjen e unazave të gatshme montuese nga betoni Ø1000 mm, kurse diamaterin e kanë 1.300 mm.	m ³	18	10.00	180.00
	2.1	Furnizimi, transporti dhe vendosja e betonimit për puseten e ujmbledhësave me dim:60*40cm.	copë	28	50.00	1,400.00
